



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 310. Akti

Nr. 449. Vendimi
Tiranë, më 22.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Bouatier, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datat 26.7.2021, ora 12:00 dhe 15.9.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish- Pallati i Koncerteve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancat dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Gina**, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga av. Eno Bushi.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DHE dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin ligjor, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Dritan Gina është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Dritan Gina i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Etleda Çiftja, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Nga Komisioni u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

3.1 Në datën 10.12.2019, Komisioni njoftoi subjektin me përbërjen e trupit gjykues dhe pyetesorin standard dhe pasi nga subjekti nuk ishte kthyer përgjigje dhe njoftimi u ridërgua më 20.4.2020, duke mos u arritur të komunikohet në rrugë elektronike me subjektin, Komisioni i nisi njoftimin e pyetesorit standard dhe përbërjen e trupit gjykues me rrugë postare subjektit të rivlerësimit si një nga format e njoftimit sipas Kodit të Procedurave Administrative.

3.2 Subjekti, pas marrjes së njoftimit mbi përbërjen e trupit gjykues në datën 4.5.2020, ka deklaruar konfliktin e interesit me anëtarin Valbona Sanxhaktari, kërkesë e cila është shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues i zgjedhur me short dhe është rrëzuar si e pabazuar në ligj.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisioneren Etleda Çiftja dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

4.1 Trupi gjykues vendosi me vendim të ndërmjetëm të bëjë pjesë të dosjes së hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit edhe dokumentacionin e administruar nga hetimi i kryer nga Komisioni për bashkëshorten e subjektit, njëkohësisht subjekt rivlersimi, duke qenë se bashkëshortja e subjektit është në cilësinë e personit të lidhur me subjektin.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina, bazuar në kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe të figurës; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe figurës, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 28.6.2021, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për kriterin e pasurisë dhe figures, duke i lënë afat deri në datën 12.7.2021 për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

6.1. Në datën 12.7.2021, subjekti ka depozituar provat dhe shpjegimet lidhur me këto dy kritere, duke kërkuar që të vazhdojë hetimi administrativ kryesisht edhe për kriterin e aftësive profesionale, duke njoftuar se subjekti është me raport shëndetësor në datat 24.6.2021 dhe 9.7.2021.

6.2 Komisioni njoftoi subjektin se seanca dëgjimore do të mbahej pasi të përfundonte raporti mjekësor në datën 16.7.2021, ora 12:00, duke e njoftuar me anë të postës elektronike se kërkesa për çeljen e hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale nuk ishte pranuar deri në këtë fazë të hetimit, kjo pasi provat për këto dy kritere kishin arritur nivelin e provueshmërisë bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

6.3. Komisioni vendosi ta shtyjë seancën në datën 26.7.2021, ora 12:00, pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur raport mjekësor dhe për arsye shëndetësore ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore.

I. SEANCA DËGJIMORE

6.4 Seanca e parë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Gina, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 26.7.2021, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier.

6.5. Në seancën e datës 26.7.2021, ora 12:00, subjekti i rivlerësimit Dritan Gina paraqiti kërkesën e përjashtimit për trupin gjykues dhe referoi një tjetër kërkesë të paraqitur më parë

(datë 4.5.2020) për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine, për të cilën nuk kishte marrë përgjigje. Trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja kryesuese, Xhensila Pine relatores dhe Valbona Sanxhaktari anëtare, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, vendosi t'i dërgojë kërkesat për t'u vlerësuar nga një tjetër trup gjykues.

6.5.1 Trupi gjykues, i cili shqyrtoi kërkesën e përjashtimit për trupin gjykues, paraqitur në seancë, dhe vlerësoi të adresojë pranë Komisionit si institucion kërkesën e patrajtuar, pasi gjatë verifikimeve të kryera u vërejt se kjo kërkesë ishte paraqitur nga subjekti në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit në datën 5.5.2020 dhe se ishte protokolluar me të njëjtin numër protokolli bashkë me kërkesën e subjektit për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues Valbona Sanxhaktari.

6.6 Gjithashtu, kjo kërkesë nuk ishte shqyrtuar nga Komisioni dhe, për pasojë, subjekti nuk kishte marrë përgjigje. Trupi gjykues, i cili shqyrtoi kërkesën e përjashtimit për trupin gjykues, paraqitur në seancën e datës 26.7.2021, ora 12:00, vlerësoi të adresojë pranë Komisionit si institucion kërkesën e patrajtuar.

6.7 Kërkesa për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine, u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues, e zgjedhur me short, dhe është rrëzuar si e pabazuar në ligj.

6.8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi subjektin se kërkesa e tij nuk ishte pranuar dhe se seanca dëgjimore me të si subjekt rivlerësimi do të zhvillohej në datën 3.9.2021.

6.9 Seanca e datës 3.9.2021 u ndërpre, kjo pasi subjekti kërkoi shtyrjen e saj, pasi përfaqësuesi i tij ligjor nuk mund të ishte i pranishëm në sallë për të bërë mbrojtjen për arsye shëndetësore, duke paraqitur edhe raportin mjekësor për mbrojtësin e tij.

6.10 Trupi gjykues, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi dhe vlerësoi raportin mjekësor të vënë në dispozicion nga subjekti Dritan Gina për mbrojtësin ligjor, vendosi të pranojë kërkesën e tij, duke e shtyrë zhvillimin e seancës për në datën 15.9.2021, në orën 13:00.

7. Seanca dëgjimore vijuese për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina u zhvillua në datën 15.9.2021. Në këtë seancë subjekti paraqiti kërkesë për përjashtimin e anëtares Etleda Çiftja dhe kërkesën për përjashtimin e gjithë anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kërkoi shtyrjen e seancës.

7.1 Pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, shqyrtoi dhe vlerësoi kërkesat e sipërcituara, trupi gjykues vendosi:

i. Mospranimin e kërkesave për shtyrjen e seancës, për shkak të kërkesave të subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e kryesueses Etleda Çiftja; (ii) për përjashtimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues, kërkesë të cilën nuk e kishte me shkrim dhe, për këtë arsye, iu kërkua subjektit dhe duke qenë se nuk e kishte kërkesën me shkrim, të dërgojë këtë kërkesë për shqyrtim në Komisionin nga një tjetër trup gjykues dhe se kërkuesi duhet ta paraqesë atë me shkrim në Komision, brenda ditës së nesërme së bashku me arsyetimin përkatës.

ii. Administrimin e kërkesës së paraqitur për përjashtimin e kryesueses Etleda Çiftja dhe dërgimin e saj në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për t'u shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues, përzgjedhur me short sipas procedurave përkatëse.

iii. Bazuar në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në paragrafin 6, të nenit 75, të Kodit të Procedurës Civile, vijimin e kësaj seance dëgjimore, por se anëtarët nuk do të marrin pjesë në dhënien e vendimit, deri sa të jepet vendimi lidhur me kërkesën e përjashtimit të trupit gjykues dhe kryesueses Etleda Çiftja.

7.2 Pasi nga trupi gjykues u njoftua se seanca do të vijonte dhe se trupi gjykues nuk do të futej në vendimmarrje deri në shqyrtimin e kërkesave të subjektit dhe njoftimin e tij lidhur me këto

kërkesa, seanca dëgjimore vijoi me paraqitjen e rezultateteve të hetimit nga ana e relatorit të çështjes dhe paraqitjen e prapësimeve të rezultateve të hetimit nga subjekti dhe përfaqësuesi i tij.

7.3 Kjo seancë u ndërpre për të vijuar në datën 22.9.2021. Në këtë seancë, subjekti paraqiti kërkesë për përjashtimin e anëtares Etleda Çiftja dhe kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues.

8. Pasi u vu në dijeni të vendimmarrjes së trupit tjetër gjykues, i cili ka vendosur mospranimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Gina, të paraqitura në seancën dëgjimore të datës 15.9.2021, për përjashtimin e kryesueses së trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja, si dhe mospranimin e kërkesës së depozituar me shkrim në Komision më 16.9.2021, protokolluar me nr. *** (kërkesë e shprehur edhe verbalisht në seancën dëgjimore të datës 15.9.2021) për përjashtimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues, në datën 21.9.2021, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, u mblodh në dhomë këshillimi dhe vendosi¹ të vijojë me procesin e vendimmarrjes për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Gina.

8.1 Vendimi i trupit gjykues u shpall në datën 22.9.2021.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

9. Z. Dritan Gina nuk ka qenë gjithomone bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur në konsideratë kërkesat procedurale të shumta dhe të përsëritura, për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues duke synuar zvarritjen e procesit, në kushtet kur Komisioni i ka garantuar të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor – madje duke i dhënë kohë të mjaftueshme shtesë për të paraqatur provat dhe shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ.

9.1 Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet veprimeve të tij për mosparaqitjen e kartës së identitetit dhe mos lejimin e kontrollit fizik nga garda e republikës, si organ përgjegjës për sigurinë e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe, më tej, hyrja me forcë në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore tregoi se nuk ishte bashkëpunues me Komisionin.

9.2 Trupi gjykues i Komisionit çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2, i ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit arrihet në konkluzionin se një sjellje e tillë ndaj një procesi kaq të rëndësishëm, jo vetëm për jetën profesionale të subjekteve, por edhe të mirëfunksionimit të vetë sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës në vend, cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës.

9.3 Në vlerësim të trupit gjykues, edhe vetëm kjo qasje e sjellje ndaj procesit të rivlerësimit do të përmbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra, atë të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. Vlerësimi i pasurisë

10. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit

11. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

¹Vendimi i ndërmjetëm datë 21.9.2021.

Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- është kryer deklarim i rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11.1 Komisioni kreu një hetim të pavarur, jo vetëm në konstatimet e ILDKPKI-së, por edhe bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe 17, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese.

A/1 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

12. Komisioni, pas kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultatit, për sa rezultoi nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni.

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti, duke u bazuar në vendimin e datës 9.4.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sipas të cilit rezultoi se, pasi janë verifikuar administrativisht pasuritë e deklaruara nga shtetasi Dritan Gina, me detyrë prokuror dhe burimet e krijimit të tyre, ka vendosur “mosfillimin e hetimit mbi referimin pasuror nr. ***, të vitit 2019”.

Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimin ligjor të mësipërm të subjektit, arsyeton si vijon:

13. Sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, është detyrë e Komisionit të hetojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

Objekti, standardet dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit *Vetting* janë të ndryshme me hetimet penale.

- Procesi i rivlerësimit *Vetting* është konceptuar si një ushtrim i jashtëzakonshëm, qëllimi i të cilit është të analizojë, *ex novo* – përmes një kontrolli të plotë – të gjitha pasuritë dhe të gjithë jetën financiare të magjistratëve shqiptarë, me synimin që të konstatohet nëse janë përfutur në mënyrë të ligjshme.

- Ky vlerësim, sipas Kushtetutës së Shqipërisë, është nën kompetencën ekskluzive të organeve të rivlerësimit *Vetting* (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit), të cilët kanë detyrimin dhe të drejtën të analizojnë specifikisht, një për një, pasuritë që subjektet zotërojnë.

- Procesi i rivlerësimit *Vetting* nuk synon të konstatojë përgjegjësi penale - rezultati mund të jetë vetëm masa disiplinore.

- Në procesin e rivlerësimit *Vetting*, subjekti duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së tij, ndërsa në hetimet penale është ekskluzivisht detyrë e prokurorisë që të provojë të gjithë elementët përbërës të veprës penale.

Kështu, *a fortiori*, procesi i jashtëzakonshëm i natyrës administrativo-disiplinore, i rivlerësimit të pasurisë së subjektit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk përjashtohet dhe nuk paragjykohet nga vendimi, datë 9.4.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

14. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se procesi i jashtëzakonshëm i natyrës administrativo-disiplinore, i rivlerësimit të pasurisë së subjektit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk përjashtohet dhe nuk paragjykohet nga vendimi, datë 9.4.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

14.1 Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve, në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

1. Apartament banimi me sip. 105 m², *, Durrës**

15. Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, rezulton deklaruar nga subjekti, pasuria apartament me sip. 105 m², regjistruar në ZVRPP-në Durrës, në shumën 80.000 euro, blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratën e shitblerjes me rezervë ligjore nr. ***, datë 6.10.2011, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

16. Si burim krijimi është deklaruar kredi bankare në shumën 45.000 euro nga “Raiffeisen Bank” dhe shuma 35.000 euro trajtim preferencial nga shtetasi O. U., prej lidhjes familjare.

17. Në deklaratën e interesave private, periodike/vjetore, të vitit 2011, në ndryshim të interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, rezulton e deklaruar: blerja e një apartamenti në zonën e ***, me sipërfaqe ndërtimi 105 m², me strukturë 2+1, në katin e ***, regjistruar në ish-ZVRPP-në Durrës, në shumën 80.000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten, në bazë të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, datë 6.10.2011, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.

18. Si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar kredi në shumën 45.000 euro marrë nga “Raiffeisen Bank”, ndërsa diferenca 35.000 euro është dhuratë. Në formularin mbi të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale)², subjekti ka deklaruar se pjesa prej 35.000 euro për blerjen e apartamentit është zbritje nga çmimi duke u konsideruar si një trajtim preferencial nga shtetasi O. U. (baxhanak i subjektit).

19. Me kontratën e shitblerjes së një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. ***, datë 6.10.2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., një apartament banimi emërtuar ap. ***, shk. ***, k. *** (*duplex*), me sip. 105 m², me strukturë 2+1, në L. ***, ***, Durrës, juridiksion i komunës Rrashbull, për një çmim të përgjithshëm, në vlerën 80.000 euro.

20. Nga vërtetimi hipotekor, datë 7.12.2011³, lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, vërehet se pasuria me sip. 105 m², *dupleks*, figuron e regjistruar në pronësi të bashkëshorteve Dritan Gina dhe R. G., me origjinë regjistrimi, datë 24.12.2009, pa barrë mbi pasurinë.

²Pjesë e DPV-së së vitit 2011.

³Pjesë e dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2020.

21. Kontrata e kredisë bankare dhe hipotekore është lidhur në datën 19.12.2011, ndërmjet “Raiffeisen Bank”, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për kreditim në shumën 45.214 euro, me qëllim për blerje apartamenti.

Lidhur me pagesën e çmimit, burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësinë financiare

22. Në kontratën e shitblerjes së një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore të datës 6.10.2011, lidhur me pagesën e çmimit të këtij apartamenti, është përcaktuar se: (i) këstin e parë në shumën 30.000 euro, pala blerëse deklaron se e ka parapaguar *cash* dhe jashtë zyrës noteriale, gjë e cila është pranuar me deklaram para noterit nga pala shitëse; (ii) këstin e dytë dhe të fundit në shumën 50.000 euro, pala blerëse pranon ta paguaj brenda datës 30.11.2011, duke u dokumentuar pagesa me transfertë bankare, shoqëruar me deklaratë noteriale të nënshkruar nga palët. Gjithashtu, në kontratë është parashikuar se me pagimin e këstit të fundit, mbi bazën e një akti noterial (deklaratës noteriale), blerësve u lind e drejta e regjistrimit të titullit të bashkëpronësisë mbi apartamentin objekt shitje në këtë kontratë.

23. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.11.2011, për pagimin e këstit të dytë dhe të fundit të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, datë 6.10.2011, pala shitëse (shoqëria “****” sh.p.k. përfaqësuar nga z. O. U.) dhe pala blerëse (subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja), pasi kanë rikonfirmuar pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes në vlerën 30.000 euro (konvertuar në shumën 4.214.100 lekë), në momentin e lidhjes së kontratës në datën 6.10.2011, pranojnë se nga ana e palës blerëse më 14.11.2011, i janë dorëzuar *cash* dhe jashtë zyrës noteriale kësti i dytë dhe i fundit i çmimit të shitjes në shumën 7.023.500 lekë.

24. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti kredinë bankare në shumën 45.000 euro nga “Raiffeisen Bank” dhe shumën 35.000 euro trajtim preferencial nga z. O. U., gjithashtu, në DPV-në e vitit 2011, si burim ka deklaruar kredinë në shumën 45.000 euro nga “Raiffeisen Bank”, ndërsa diferencën prej 35.000 euro si dhuratë.

25. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank” rezulton se në llogarinë në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 21.12.2011 është disbursuar kredia në vlerën 45.214 euro. Në datën 22.12.2011, shuma prej 44.400 euro është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrim “pagesë për blerje shtëpie sipas kontratës nr. ****”.

26. Gjithashtu, referuar dokumentacionit, pjesë të dosjes së ILDKPKI-së⁴ të bashkëshortes së subjektit, llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k., është debituar në datën 22.12.2011, në shumën 44.400 euro me përshkrim “**** sh.p.k. likuidim fature”.

27. Me deklaratën (shkresë e thjeshtë) e datë 19.1.2017, z. O. U. deklaron se në cilësinë e ortakut të shoqërisë “****” sh.p.k., por edhe të përfaqësuesit të kësaj shoqërie në kontratën e shitblerjes me objekt pasurinë e sipërpërmendur (në bazë të prokurës së përgjithshme, datë 11.2.2008), ka realizuar një zbritje preferenciale prej 35.000 euro, mbi çmimin e përgjithshëm prej 80.000 euro, për palën blerëse R. Gashi. dhe Dritan Gina, për shkak të marrëdhënies së afërt familjare me ta (znj. R. G. është motra e bashkëshortes së tij, znj. E. G.).

28. Kontrata për sipërmarrje në ndërtim nr. ***, datë 16.1.2008, ka përcaktuar si palë investitore financiare të sipërmarrjes në ndërtim shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga ortaku dhe administratori i përgjithshëm, z. I. H., palë zbatuese të sipërmarrjes së ndërtimit, shoqërinë

⁴F. ***.

ndërtuese “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori O. U. dhe palën porositëse, pronarin e tokës truall (shesh ndërtimi), z. N. S..

29. Shoqëria “****” sh.p.k, me shkresë nr. *** prot., datë 1.8.2017, në lidhje me këtë apartament, informon ILDKPKI-në, ndër të tjera, se: “... referuar lidhjes së posaçme familjare ndërmjet ortakut O. U., të shoqërisë investuese dhe njëkohësisht administrator i shoqërisë së ndërtimit të këtij objekti dhe blerësve, shoqëria ‘****’ sh.p.k., ka aplikuar një çmim preferencial, në vlerën prej 45.000 euro, duke i zbritur palës blerëse vlerën e detyrimit prej 35.000 euro të çmimit të shitjes të deklaruar në kontratën e shitjes me rezervë të pronës, në formën e faljes së detyrimit.

30. Ndërsa deklarimi i shlyerjes dhe të pjesës tjetër të çmimit prej blerësve në favor të shoqërisë është bërë për efekt të garantimit të kalimit të të drejtës së pronësisë mbi këtë apartament banimi të blerësit, me qëllim për t’u mundësuar atyre vënien në hipotekë të këtij apartament banimi, si mjet për të garantuar lëvrimin e kredisë së kërkuar te ‘Raiffeisen Bank’.

31. Sipas vërtetimit hipotekor të lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, kjo pasuri është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, e lirë nga çdo pretendim i shitësit, ndërkohë që në një kohë të mëpasshme, subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur, kanë lidhur kontratën e kredisë bankare dhe hipotekare të datës 19.12.2011, duke përfituar nga “Raiffeisen Bank” kredinë në shumën 45.214 euro.

32. Referuar dokumentacionit, pjesë të dosjes⁵ së ILDKPKI-së të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se nga raportimi i akteve noteriale⁶ burimi i fondeve për blerjen e apartamentit të banimit në shumën 80.000 euro është përshkruar “nga puna”

33. Nga aktet e administruara në dosje nga Komisioni, pasqyruar edhe më sipër, duket se likuidimi i çmimit të blerjes së këtij apartamenti është kryer në datat 6.10.2011 dhe 14.11.2011, duke provuar se shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm janë kryer para marrjes së kredisë në “Raiffeisen Bank”.

34. Sa më sipër, duket se ka mospërputhje në lidhje me vlerën e paguar, kohën e pagesës, si dhe burimin e të ardhurave të deklaruara për blerjen e këtij apartamenti me dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ.

35. Nga Komisioni u vlerësua se shuma e përfituar nga kredia në datën 21.12.2011, nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e çmimit të këtij apartamenti, ndërsa vlera prej 44.400 euro e transferuar për shoqërinë “****” sh.p.k. në datën 22.12.2011, të pasqyrohet si shpenzim në analizën paraprake financiare.

36. Referuar dokumentacionit të disponuar, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, nga Komisioni u krye analiza e treguesve financiarë, për periudhat 1.1.2011 – 6.10.2011 dhe 1.1.2011 – 14.11.2011, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur, për pagesën e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit në Durrës.

37. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit:

i) ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën reale të paguar, kohën e pagesës, si dhe burimin përkatës të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme;

⁵Dokument me nr. ****, në inventarin të dosjes së subjektit Dritan Gina.

⁶Kontratë shitblerje të një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. ****, datë 6.10.2011+deklaratë noteriale për pagim kësti.

ii) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes për pasurinë apartament banimi me sip. 105 m², në zonën e ***, Durrës, në datën 6.10.2011, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara, për periudhën 1.1.2011– 6.10.2011, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.909.121 lekë;

iii) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të plotë të blerjes për pasurinë apartament banimi me sip. 105 m², në zonën e ***, Durrës, në vlerën 80.000 euro, deri në datën 14.11.2011, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2011 – 14.11.2011, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 8.870.932 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

38. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar se *ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti banimi në vlerën prej 44.400 euro, pagesë e cila është bërë me bankë në llogari të shoqërisë shitëse, drejtpërdrejtë pas disburimit të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit Dritan Gina, në këtë shumë, pikërisht, për blerjen e këtij apartamenti.*

39. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues: deklaratë, datë 6.10.2011, të shoqërisë “****” sh.p.k.; deklaratë nr. *** prot., datë 19.1.2017, të shoqërisë “****” sh.p.k.; vërtetim nr. *** prot., datë 8.7.2021; formularët e aplikimit për kredi konsumatore të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 8.7.2021; praktika e kontratës së kredisë bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 19.12.2011; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.4.2018; kërkesë për transfertë fondesh në datën 21.12.2011; mandat bankar për nxjerrje llogarie, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në datën 1.2.2012; procesverbal i deklarimeve të dhëna nga shtetasi O. U./ortak i shoqërisë “****” sh.p.k. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 12.10.2018; dokumentacioni juridik, bankar, ekonomiko-financiar, kartelat e klientit dhe dokumentacioni tatimor që disponon shoqëria “****” sh.p.k., në lidhje me klientët Dritan Gina dhe R. G.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.7.2021;

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

40. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e përfaqësuesit ligjor dhe të subjektit në seancë, arsyeton se:

41. Në vlerësim të situatës faktike, lidhur me vlerën e paguar për pasurinë, ekzistojnë mospërputhje mes deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara, pasi subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e paguar për këtë pasuri ka qenë në 44.400 euro.

42. Sa më sipër, vjen në kundërshtim me kontratën e shitblerjes të kësaj pasurie të paluajtshme të datës 6.10.2011 dhe lidhur me pagesën e çmimit të këtij apartamenti, palët kanë përcaktuar se: (i) kësti i parë në shumën 30.000 euro i është parapaguar *cash* palës blerëse jashtë zyrës noteriale; (ii) kësti i dytë dhe i fundit në shumën 50.000 euro, nga pala blerëse do të paguhej brenda datës 30.11.2011.

43. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.11.2011, palët shitëse dhe blerëse kanë rikonfirmuar pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes në vlerën 30.000 euro, në momentin e lidhjes së kontratës në datën 6.10.2011, si dhe pranojnë se nga ana e palës blerëse në datën 14.11.2011,

i janë dorëzuar *cash* jashtë zyrës noteriale, kësti i dytë dhe i fundit i çmimit të shitjes në shumën 7.023.500 lekë.

44. Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

44.1.Në nenin 660 të Kodit Civil, parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

44.2.Në nenin 663 të Kodit Civil, përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*.

44.3 Në nenin 690 i Kodit Civil, parashikohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

45. Nga trupi gjykues vlerësohet se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën e shitblerjes dhe deklaratën noteriale të nënshkruar mes palëve, të cilat konfirmonin vlerën e paguar të çmimit për blerjen e këtij apartamenti, pasi nuk ka as kundërshtim, sipas ligjit, të tyre, as rregullim të pasojave që ato kanë sjellë.

45.1 Trupi gjykues gjen te pabazuar ne ligj arsytimine subjektit sipas të cilit ligji tatimor e detyronte atë të vendoste çmimin e plotë prej 80 000 EURO (edhe pse kishte një zbritje prej 35 000 EURO) pasi bazuar në nenin 660 të Kodit Civil, parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

45.2. Në kushtet kur nuk ka kundërshtim, sipas ligjit të këtij akti noterial, deklarata noteriale e datës 14.11.2011, është fuqplotë për atë çka dëshmon, pra, në shlyerjen e plotë të shumave objekt kontrate dhe kalimin e pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm para marrjes së kredisë në “Raiffeisen Bank”, në datën 19.12.2011.

46. Mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁷, ndodhur nga njëra anë para një kontrate të nënshkruar me marrëveshje dhe vullnet të plotë para noterit, e cila ka përcaktuar qartë kushtet e shitblerjes dhe likuidimit të çmimit, faktet e parashtruara nga subjekti nuk provohen dhe janë në kundërshtim me kontratën e firmosur nga vetë palët.

47. Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, trupi gjykues vlerëson se edhe në rastin e hipotezës *mere hypothesis and obiter dictum*, nëse teorikisht për një moment mund të supozohet se argumenti i subjektit ka qenë real/ i vërtetë, duke marrë në konsideratë deklaratimet e tij, në rastin konkret, nga vetë subjekti i rivlerësimit, pranohet se palët kanë qenë të ndërgjegjshme dhe kanë rënë dakord që çmimi real i shitjes do të ishte në vlerën 44.000 euro, por pavarësisht kësaj ato kanë proceduar dhe nënshkruar kontratën e shitjes me çmim në vlerën 80.000 euro dhe e kanë paraqitur këtë vlerë para bankës, duke kërkuar që shuma prej 44.000 eurosh të mbulohej nga kredia e përfituar prej saj, si dhe para ZVRPP-së, duke kërkuar regjistrimin e blerjes së kësaj pasurie me këtë vlerë.

48. Trupi gjykues vlerëson se subjekti referuar shpjegimeve do të ndodhej para pranimit të faktit se kontrata e hartuar nga palët apo edhe deklarata noteriale në vijim, e cila konfirmonte pagimin e çmimit të plotë të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të kontratës, ishin dokumente ligjorë të

⁷Vendim nr. 2/2019.

nënshkruar prej tij, pavarësisht se prej tij ishte e njohur edhe e pranuar përmbajtja e parashikimeve për çmim të pavërtetë dhe për shlyerje detyrimesh, të cilat nuk i kishte shlyer dhe nuk kishte qëllim t'i shlyente.

49. Për sa kohë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, pasi të dhënat nuk mbështeteshin nga dokumentacionin ligjor nënshkruar mes palëve, të cilat lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie, e vendosin në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, si dhe germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 121 m², në rrugën “**”, Tiranë**

50. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar këtë pasuri të regjistruar në emër të tij dhe të bashkëshortes, me burim krijimi dhurim nga babai i bashkëshortes me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.11.2013.

51. Në DPV-në e vitit 2013, në ndryshim të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë apartament banimi të dhuruar nga babai i bashkëshortes me deklaratë noteriale, i cili e ka zotëruar këtë pronë që prej vitit 2004.

52. Në kontratën e porosisë të datës 28.10.2004, ndërmjet babait të bashkëshortes së subjektit, shoqërisë ndërtuese “E” sh.p.k. dhe investitorit T. M., me objekt “porosi për blerjen e një apartamenti banimi”, çmimi i shitjes është caktuar në vlerën 38.800 USD, e cila është likuiduar nga blerësi në favor të shitësit.

53. Me deklaratën noteriale, datë 2.11.2013, babai i bashkëshortes ka deklaruar se ka vendosur të heqë dorë nga pronësia e apartamentit dhe t’ia dhurojë vajzës R. G. dhe bashkëshortit Dritan Gina, duke shfuqizuar kontratën e datës 18.10.2004.

54. Kontrata e shitblerjes, datë 12.11.2013, është lidhur midis palëve R. G. dhe Dritan Gina me shoqërinë ndërtuese “E” sh.p.k. dhe investitorit T. M., sipas deklaratës noteriale, datë 2.11.2013, për blerjen e pasurisë së sipërcituar, në të cilën specifikohet⁸ se znj. R. G. dhe z. Dritan Gina i kanë likuiduar totalisht investitorit çmimin e shitjes prej 38.800 USD, të vendosur për apartamentin e mësipërm, përpara regjistrimit në ZVRPP-në Tiranë dhe jashtë zyrës noteriale.

55. Në bazë të certifikatës për vërtetim pronësie të datës 20.11.2013, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, ky apartament figuron i regjistruar në pronësi të znj. R. G. dhe të z. Dritan Gina, me shënimin kontratë shitblerjeje, datë 12.11.2013.

56. Kontrata (me shkresë të thjeshtë) e datës 28.10.2004, ndërmjet palës shitëse dhe babait të bashkëshortes së subjektit, nuk është kontratë porosie dhe as sipërmarrjeje, por kontratë shitje e një sendi të paluajtshëm në të ardhmen, për të cilën ligji kërkon akt noterial.

57. Bazuar në nenin 660 të Kodit Civil, palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi dhe bazuar në nenin 681, kur interpretohet një kontratë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin literal të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

58. Në bazë të neneve 705 dhe 706 të Kodit Civil, kontrata e shitjes që ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi dhe në shitjen

⁸Neni 3 “Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës”.

që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, bëhet sapo sendi ose e drejta pranohet se ekzistojnë.

59. Neni 750 i Kodit Civil, përcakton se shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij kodi, përndryshe është e pavlefshme, ndërsa neni 83 i Kodit Civil përcakton se veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.

60. Në referim të sa më sipër, kontrata nr. ***, datë 12.11.2013, nënshkruar te notere Nadire Karadaku, në të cilën ky apartament rezulton të ketë qenë objekt i kontratës ku palë shitëse është shoqëria “E” sh.p.k. dhe investitori T. M. dhe palë blerëse bashkëshortët Dritan Gina dhe R. G., sipas së cilës çmimi i shitjes së apartamentit është gjithsej 38.800 USD dhe se ia kanë likuiduar totalisht investitorit këtë shumë të vendosur për apartamentin e mësipërm, përpara regjistrimit të tij në ZVRPP-në Tiranë dhe jashtë zyrës noteriale.

61. Bazuar në nenin 68 të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, “Për noterinë”, pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohet nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta dhe merr përsipër detyrime prej tyre dhe kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale.

62. Në kushtet e moskundërshtimit, sipas ligjit dhe rregullimit të pasojave që kontrata e shitjes ka sjellë, ajo është fuqplotë për atë çka dëshmohet. Në rastin konkret, dëshmohet shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm sipas kontratës së shitjes së datës 12.11.2013.

63. Për sa i përket referimit në kontratën e porosisë, datë 28.10.2004, neni 111 i Kodit Civil, përcakton se kur shkak i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik.

64. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike⁹ konfirmon se kontrata e furnizimit me energji elektrike për këtë apartament është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është hapur në datën 18.11.2004.

65. Në bazë të të dhënave nga Ujësjiellës Kanalizime Tiranë¹⁰, kontrata për objektin në adresën rruga “***”, është në emër të subjektit të rivlerësimit dhe është hapur në datën 31.10.2004.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se ky apartament duket se është blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.10.2004, kundrejt shumës 38.800 USD.

66. Mbështetur në dokumentacionin e administruar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerje të apartamentit me sip. 121 m², në rrugën “***”, në datën 28.10.2004, në shumën 38.800 USD.

67. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit:

i) ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me këtë pasuri;

⁹Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.1.2018.

¹⁰Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.01.2018.

ii) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e blerjes së këtij apartamenti në datën 28.10.2004, në shumën 38.800 USD, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara, për periudhën 1.1.2004 – 28.10.2004, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 3.142.936 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

68. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, pas kalimit të barrës së provës ishte se deklarimet e tij, në lidhje me këtë pasuri, pagesën e kryer për blerjen e saj, mënyrën e krijimit dhe burimin e financimit të saj, përputhen me dokumentacionin e dorëzuar dhe deklaratat e palëve të përfshirë në këtë marrëdhënie juridike, akte që i administrojnë edhe institucionet shtetërore dhe që janë verifikuar dhe vërtetuar edhe në kuadër të hetimit pasuror të zhvilluar për këtë subjekti dhe se deklarimi i subjekti të rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, është i saktë, i rregullt, në përputhje me ligjin dhe se burimet e krijimit të kësaj pasurie janë të ligjshme.

69. Subjekti ka depozituar në Komision dokumentacionin në vijim: kontratë porosie, datë 28.10.2004; vërtetim nënshkrimi të aktit noterial nr. *** rep., datë 2.11.2013; deklaratë noteriale nr. ***, date 2.11.2013; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.11.2013, procesverbal, datë 11.10.2018; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.8.2018, të OSHEE-së, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për informacionit e kërkuar nga kjo e fundit në kuadër të hetimit pasuror me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2018, kontratë nr.***, për furnizimin me energji elektrike për këtë apartament banimi lëshuar nga KESH në emër të shoqërisë “****” sh.p.k; librezë e energjisë elektrike për këtë apartament banimi në emër të investitorit T. M.; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.8.2018, të UKT-së drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për informacionit e kërkuar nga kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2018, në kuadër të hetimit pasuror të zhvilluar ndaj subjektit të rivlerësimit Dritan Gina; deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.9.2018, e shtetasit T. M; si dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.9.2018, e shtetasit N. G..

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

70. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet e përfaqësuesit ligjor dhe të subjektit në seancë, arsyeton se:

71. Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Në nenin 660 të Kodit Civil, parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

72. Në nenin 663 të Kodit Civil, përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*. Në nenin 690 i Kodit Civil, parashikohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

73. Në kushtet e moskundërshtimit, sipas ligjit dhe rregullimit të pasojave që kontrata e shitjes ka sjellë, ajo është fuqiplotë për atë çka dëshmohet. Në rastin konkret, dëshmohet shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm, sipas kontratës së shitjes, datë 12.11.2013, në secilin prej skenarëve të mundshëm të pagimit të

çmimit nga subjekti dhe bashkëshortja, sipas parashikimeve të kontratës ligjore të nënshkruar prej tyre, lidhur me blerjen e apartamentit do të rezultojnë me pamjaftueshmëri financiare.

74. Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, trupi gjykues vlerëson se edhe në rastin e hipotezës *mere hypothesis and obiter dictum*, nëse teorikisht për një moment mund të supozohet se argumenti i subjektit ka qënë real/ i vërtetë, duke marrë në konsideratë deklaratimet e tij, në rastin konkret, nga vetë subjekti i rivlerësimit, pranohet se ka nënshkruar një kontratë para noterit publik, ku pranohet se së bashku me bashkëshorten kanë paguar çmimin për blerjen e këtij apartamenti dhe kanë qënë të ndërgjegjshme se ky ishte një fakt i pavërtetë, sipas shpjegimeve të tyre, por pavarësisht kësaj ato kanë proceduar dhe nënshkruar kontratën e shitjes me deklarinimin se çmimi i paguar prej tyre dhe se ato ishin blerësit e kësaj pasurie.

75. Trupi gjykues vlerëson se subjekti referuar shpjegimeve do të ndodhej para pranimit të faktit se kontrata e hartuar nga palët, e cila konfirmonte pagimin e çmimit të plotë të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të kontratës ishin dokumente ligjore të nënshkruar prej tij, pavarësisht se prej tij ishte e njohur edhe e pranuar se përmbajtja e parashikimeve për pagimin e çmimit ishin të pavërteta dhe sikundër ishin të pavërteta edhe deklaratimet e tij për shlyerje detyrimesh të cilat nuk i kishte shlyer dhe nuk kishte qëllim t'i shlyente.

76. Parë nga ky këndvështrim, veprimet e subjektit nuk do përputheshin me sjelljen etike që një prokuror pritët të ketë dhe që duhet të demonstrojë, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe jashtë saj, duke marrë në konsideratë autoritetin dhe reputacionin që përfaqëson.

77. Për sa kohë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, pasi të dhënat nuk mbështetësin nga dokumentacioni ligjor nënshkruar mes palëve, të cilat lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie, e vendosin në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, si dhe të germës “a”, pikës 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

3. Depozitë në “Credins Bank”, në vlerën 10.000 euro, çelur në datën 23.12.2016

Burimi i krijimit: kursime, ndër vite, me ardhura nga paga e subjektit.

78. Më sipër¹¹ është analizuar deklarimi i gjendjeve *cash* në banesë deri në fund të vitit 2010, nga ku rezultoi se deri në datën 31.12.2010, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar kursime *cash* në shumën 2.200.000 lekë.

79. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit në ndryshim të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme ka deklaruar, shtuar kursimet me të ardhurat nga paga në shumën 300.000 lekë, ndërsa bashkëshortja në deklaratën e saj ka deklaruar shtuar kursime me të ardhura nga paga në shumën 200.000 lekë.

79.1. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar shtim të kursimeve me burim të ardhurat nga paga në shumën 100.000 lekë, ndërsa bashkëshortja në deklaratën e saj ka deklaruar, shtuar kursime me të ardhura nga paga në shumën 200.000 lekë.

79.2. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar ndryshim (shtesa/pakësime) të gjendjeve *cash* në banesë.

79.3. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat së bashku me bashkëshorten në shumën 500.000 lekë.

¹¹Footnote fq. 6 i rezultateve.

79.4 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar kursime nga paga së bashku me bashkëshorten në shumën 300.000 lekë.

79.5 Sa më sipër, shuma e kursimeve *cash* të mbledhura deri në datën 31.12.2015, referuar deklaramenteve periodike, rezulton në vlerën 3.800.000 lekë.

80. Për sa i përket kursimeve të deklaruara si shtesë të gjendjeve *cash* deri në vitin 2010, janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni për mundësinë e pagesës së kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit në ***, Durrës, në tetor dhe nëntor të vitit 2011 dhe përsëri ka rezultuar pamjaftueshmëri për të mbuluar blerjen e pasurisë dhe shpenzimeve.

81. Në lidhje me shumën e deklaruar të kursyer në DPV-të e viteve 2011 dhe 2012, nga analiza paraprake e treguesve financiarë e kryer nga Komisioni, duket se viti i mbyllur 2011 dhe 2012, rezulton me balancë negative fondesh (përkatësisht -9.092.183 lekë dhe -257.330 lekë), si rrjedhim, subjekti dhe bashkëshortja duket se nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin plotësisht të shtesës *cash* në vitin 2011 dhe 2012. Por edhe nëse në vitin 2012 mundësia e krijimit të kursimeve ka qenë në shumën 42.670 lekë (300.000 lekë -257.330 lekë), përsëri kjo shtesë në likuiditete, duket se është përdorur në vitin 2013, pasi ky vit rezulton paraprakisht me balancë negative të fondeve në vlerën 153.954 lekë.

82. Për sa i përket kursimeve të deklaruara si shtesë të gjendjeve *cash* në vitet 2014 dhe 2015, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duket se për këto vite rezulton balancë negative fondesh përkatësisht në vlerat 94.502 lekë dhe 437.386 lekë.

83. Sa më sipër, duket se burimi i të ardhurave deklaruar nga subjekti ka qenë i pamjaftueshëm për krijimin e depozitës në vlerën 10.000 euro (konvertuar në 1.352.300 lekë), në emër të bashkëshortes së subjektit në “Credins Bank”.

84. Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara/provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si edhe informacionin/dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për vitin 2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë vit.

85. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit se duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitës në vlerën 10.000 euro, në emër të bashkëshortes në “Credins Bank”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara dhe të deklaruara për vitin 2016, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.069.317 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

86. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit Dritan Gina për këtë depozitë janë vlerësuar të sakta dhe burimet e krijimit të saj janë konsideruar të ligjshme, sipas vendimit nr. 48, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është lenë në fuqi me vendimin nr. 12, datë 29.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në këtë kuadër nuk vihen më në dyshim apo të vlerësohet e kundërta.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

87. Trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rregullt ligjor, garantuar nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, përfshin të drejtën për të pasur një hetim të pavarur për secilin nga subjektet e rivlerësimit, bashkëshortë midis tyre dhe të një vendimi të arsyetuar të bazuar në rezultatet e hetimit dhe në provat dhe shpjegimet e subjektit, prandaj në këtë drejtim

gjetjet edhe arsyetimi, lidhur me këtë pikë, nuk kufizohet nga arsyetimi i bërë nga një trup tjetër gjykues për bashkëshorten, i cili është rezultat i gjetjeve të trupës tjetër gjykuese, lidhur me këtë subjekt..

88. Ndërsa vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në zbatim të të pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës, shqyrton dhe është shprehur vetëm mbi faktet e ngritura në ankimin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, prandaj në këtë drejtim gjetjet edhe arsyetimi i Kolegjit nuk kufizon nga arsyetimi lidhur me këtë pasuri.

89. Referuar pikës 1, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, kjo pasuri e luajtshme sipas kuptimit të dhënë në pikën 11, të nenin 3, e ligjit të rivlerësimit, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim.

90. Komisioni, pasi kreu analizën e treguesve financiarë për vitin 2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë vit, si dhe pasi analizoi shpjegimet e tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me pamundësinë për krijimin e depozitës në vlerën 10.000 euro, në “Credins Bank”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara dhe të deklaruara për vitin 2016, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.069.317 lekë.

91. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në vitin 2016, sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Automjet tip “Peugeot 308”, me vlerë 15.100 euro

92. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar marrjen e një kredie në “Credins Leasing”, për blerjen e autoveturës tip “Peugeot 308”, me targa ***, si dhe ka deklaruar se *autovetura është blerë në shumën 15.100 euro (shlyer shuma 3.100 euro)*.

93. Me kontratën e qirasë financiare nr. ***, datë 21.9.2010, znj. R. G. (bashkëshortja e subjektit), në cilësinë e qiramarrësit dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e dorëzanësit, janë financuar me *leasing* nga ana e qiradhënësit shoqërisë “Credins Leasing” sh.a., për një automjet tip “Peugeot 308”, kundrejt çmimit të furnizimit 15.120 euro. Në këtë kontratë është parashikuar pagesa brenda 5 ditëve nga qiramarrësi të shumës 3.000 euro, si dhe të gjitha shpenzimet e regjistrimit të automjetit në favor të qiradhënësit. Shuma e financuar në këtë kontratë është 12.120 euro dhe afati i financimit është 60 muaj.

94. DPSHTRR-ja¹² ka konfirmuar pronësinë e automjetit me targa ***, në emër të znj. R. G.. Bashkëshortja e subjektit ka fituar pronësinë për automjetin tip “Peugeot 308”, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 3.9.2015, me shoqërinë “Credins Leasing”.

¹²Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.1.2018.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

95. Si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në DPV-të për vitet 2010 – 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim të të ardhurave për pagesën e shumave për shlyerjen e kësteve të qirasë financiare.

96. Burimet e të ardhurave, ndonëse të padeklaruara nga subjekti, janë shqyrtuar duke analizuar të ardhurat e dokumentuara, kursimet dhe mundësinë që me këto të ardhura të mbulohen blerjet e pasurive, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe të evidentuara në periudhën 2010 – 2015 (pasqyruar në kategorinë shpenzime në analizën e përgjithshme paraprake të treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016).

97. Referuar analizës të treguesve financiarë¹³, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijim të pasurive, përfshirë edhe shtesën në kursime, si dhe kryerjen e shpenzimeve, përkatësisht: (i) në vitin 2010 balancë negative në vlerën 293.034 lekë; (ii) në vitin 2011 balancë negative në vlerën 9.092.183 lekë; (iii) në vitin 2012 balancë negative në vlerën 257.330 lekë; (iv) në vitin 2013 balancë negative në vlerën 153.954 lekë; (v) në vitin 2014 balancë negative në vlerën 94.502 lekë; si dhe (vi) në vitin 2015 balancë negative në vlerën 437.386 lekë.

98. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, duke u mbështetur edhe në analizën për deklarimin dhe mundësinë e krijimit të gjendjeve *cash* të deklaruara, të cilat gjenden të pasqyruara/analizuar në pasuritë nr. 1 dhe 3, përveç sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit, për vitet e mbyllura 2011 dhe 2013, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shpenzimet e qirasë financiare *leasing* për automjetin tip “Peugeot 308”, blerje/krijim të pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për këto vite.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

99. *Deklarimet për këtë automjet janë vlerësuar të sakta dhe burimet për blerjen e këtij automjeti janë konsideruar të ligjshme sipas vendimit nr. 48, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 12, datë 29.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në këtë kuadër, nuk mund të vihen më në dyshim apo të vlerësohet e kundërta.*

Trupi gjykues për subjektin e rivlerësimit ka arritur në konkluzionin se deklaratimet e subjektit, në lidhje me këtë pasuri, përputhen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe, në këtë kuadër, deklarimi i subjektit të rivlerësimit Dritan Gina është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe burimet krijimit të kësaj pasurie janë të ligjshme.

Për sa më lart vërtetohet plotësisht se deklarimi i subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, në lidhje me këtë automjet, është i saktë, përputhet me dokumentacionin e administruar dhe burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të mjaftueshme dhe janë të ligjshme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

100. Trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rregullt ligjor, garantuar nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, përfshin të drejtën për të pasur një hetim të pavarur për secilin nga subjektet e rivlerësimit bashkëshortë midis tyre dhe të një vendimi të arsyetuar të bazuar në rezultatet e hetimit dhe në provat dhe shpjegimet e subjektit, prandaj në këtë drejtim gjetjet edhe arsyetimi lidhur me këtë pikë nuk kufizohet nga arsyetimi i bërë nga një

¹³ Aneks bashkëlidhur rezultateve të hetimit.

trup tjetër gjykues për bashkëshorten, i cili është rezultat i gjetjeve të trupit tjetër gjykues, lidhur me këtë subjekt.

101. Ndërsa vendimi i Kolegji të Posaçëm të Apelit në zbatim të nenit 179/b, të pikës 5, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës, shqyrton dhe është shprehur vetëm mbi faktet e ngritura në ankimin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, prandaj në këtë drejtim gjetjet edhe arsyetimi i Kolegjit nuk kufizohen nga arsyetimi lidhur me këtë pasuri.

102. Referuar pikës 1, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, kjo pasuri e luajtshme, sipas kuptimit të dhënë në pikën 11, të nenin 3, e ligjit të rivlerësimit, objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duhet t'i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërisë së burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, në procesin administrativ.

103. Ky konkluzion i trupit gjykues, mbi detyrimin e parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafët 1 dhe 4, vlerësohet në referim edhe të rrethanave faktike dhe faktit se blerja e këtij automjeti është kryer gjatë martesës së dy subjekteve të rivlerësimit dhe të dy së bashku kanë kontribuar për këtë pasuri.

104. Komisioni, pasi kreu analizën e treguesve financiarë për vitet 2011 – 2013, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë vit, si dhe pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke u mbështetur edhe në analizën për deklarimin dhe mundësinë e krijimit të gjendjeve *cash* të deklaruara, të cilat gjenden të pasqyruara/analizuar në pasuritë nr. 1 dhe 3. Përveç sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit, për vitet e mbyllura 2011 dhe 2013, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shpenzimet e qirasë financiare *leasing* për automjetin tip “Peugeot 308”, blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për këto vite.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vitin 2011 dhe në vitin 2013, sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

105. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, ku Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit*, duke referuar se ky raport është pa përgjigjen nga një nga organet verifikuese.

106. Në vijim, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës dhe ka administruar edhe raportin e SHISH-it, ka paraqitur pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë 24.11.2020, ku Grupi i Punës nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmërinë

për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, në papërshatshmëri për vazhdimin e detyrës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së.

107. Sipas këtij raporti informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin e një prokurori, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdo përfitimi të parregullt për të kryer apo moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, cenojnë drejtpërdrejt pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

108. Nisur nga informacioni i ardhur nga autoritetet verifikuese, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga autoritetet verifikuese për të cilat dyshohej se subjekti i rivlerësimit mund të kishte favorizuar persona të proceduar penalisht. Në përfundim të këtyre hetimeve rezultoi se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese, si dhe u krijua bindja në vërtetësinë e informacionit të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese.

109. Komisioni, nga informacioni i dhënë në raportin e DSIK-së, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4, i ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion dhe analizoi dosjet penale, si vijon:

Referuar të dhënave të administruara për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni administroi procedimin penal nr. ***, datë 10.11.2014, urdhëruar regjistrimi nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke vendosur si vijon: regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “falsifikim i kartëmonedhave”, “falsifikimi i dokumenteve”, “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”, parashikuar nga nenet 183/2, 186/2 dhe 189/2, të Kodit Penal.

110. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, konkretisht shtetasit:

- A. P., i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 183/2, 186/2 dhe 189/2 të Kodit Penal; dhe
- M. S., i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 183/2, 186/2 e 189/2 të Kodit Penal .

Shënimin e emrit të personit nën hetim në regjistrin e njoftimit të veprave penale për procedimin penal nr. ***, të vitit 2014, për shtetasit:

- Q. G., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 186/2, 189/2 dhe 190/2, të Kodit Penal; dhe
- M. H., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 186/2 dhe 192, të Kodit Penal.

Vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 15.3.2015, të prokurorit Dritan Gina, konfirmuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, për: zgjatjen e afatit të hetimeve për 3 (tre) muaj për shtetasin nën hetim Q. G., duke filluar nga 15.3.2015 – 15.6.2015.

Të njihet me këtë vendim i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2014, me objekt “dërgojmë materiale hetimore”, Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Durrës, materiale procedurale shitesë për llogari të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të shtetasve A. P., Q. G. dhe M. H., si persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/2, 189/2 dhe 190/2 të Kodit Penal.

Vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 10.2.2015, të prokurorit Dritan Gina, konfirmuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, për zgjatjen e afatit të hetimeve për 3 (tre) muaj për shtetasin nën hetim A. P., duke filluar nga data 10.2.2015 – 10.5.2015.

Të njihet me këtë vendim i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me vendim për ndarjen e procedimit penal, datë 3.4.2015, prokurori i çështjes Dritan Gina ka vendosur:

Ndarjen e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurve Q. G. dhe A. P., akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/2, i Kodit Penal, në procedimin penal nr. ***, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/2, i Kodit Penal, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit M. H., i biri i shtetasve M. dhe R., i datëlindjes 13.10.1964.

Me vendim për pushimin e ndjekjes penale, datë 3.4.2015, prokurori i çështjes Dritan Gina ka vendosur:

Pushimin e ndjekjes penale të shtetasit M. S. në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2014, për kryerjen e figurës së veprës penale të parashikuar nga nenet 183/2, 186/2 dhe 189/2, të Kodit Penal.

Pushimin e ndjekjes penale të shtetasit A. P. në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2014, për kryerjen e figurës së veprës penale të parashikuar nga nenet 183/2 dhe 189/2, të Kodit Penal.

Pushimin e ndjekjes penale të shtetasit Q. G., në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2014, për kryerjen e figurës së veprës penale të parashikuar nga nenet 189/2 dhe 190/2, të Kodit Penal.

Me vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës së datës 1.4.2015, prokurori i ka njoftuar akuzën të pandehurit Q. G. për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Me vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës së datës 1.4.2015, prokurori i ka njoftuar akuzën të pandehurit A. P. për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Me shkresën “dërgim kërkese” nr. ***, datë 7.4.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i ka dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, datë 10.11.2014, në ngarkim të të pandehurve Q. G. dhe A. P., të akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Me vendimin nr. (***) ***, datë 30.4.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale ‘falsifikim të dokumenteve’ dhe sipas nenit të nenit 186/2 të Kodit Penal e dënon atë me 10 muaj burgim”*.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit të dhënë dhe përfundimisht i pandehuri A. P. dënohet me 6 muaj e 20 ditë burgim.

Vuajtja e dënimit i ka filluar nga dita e arrestimit datë 15.12.2014.

Meqenëse ky dënim i dhënë nga gjykata rezulton i vuajtur urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit A. P..

Deklarimin fajtor të të pandehurit Q. G. për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve” dhe në bazë të nenit 186/2, të Kodit Penal e dënon me 10 muaj burgim.

Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit të dhënë dhe përfundimisht i pandehuri Q. G. dënohet me 6 muaj e 20 ditë burgim.

Vuajtja e dënimit i ka filluar nga dita e arrestimit në datën 15.12.2014.

Meqenëse ky dënim i dhënë nga gjykata rezulton i vuajtur, urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit A. P..

Lidhur me procedimin penal nr. ***, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/2, i Kodit Penal, të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit M. H., i biri i shtetasve M. dhe R., i datëlindjes 13.10.1964.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

111. *Çështja penale nr. ***, ka qenë objekt kontrolli administrativ dhe penal nga organet kompetente shtetërore dhe në këtë kuadër përbën gjë të gjykuar për faktet e verifikuara dhe konkluzionet e arritura, për sa i përket veprimtarisë profesionale dhe figurës së prokurorit të kësaj çështje Dritan Gina dhe që sot, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit Ç, pika 2 dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkluzioneve detyruese të vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe përcaktimeve të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, duhet të vlerësohen me objektivitet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, sipas parimit “të gjësë së gjykuar” dhe “sigurisë juridike”.*

*Rezultatet e verifikimit dhe vlerësimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në lidhje me këtë informacion për prokurorin Dritan Gina, i janë komunikuar SHISH nga Prokuroria e Krimeve të Rënda me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2017. Rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2017, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka informuar edhe Prokurorinë e Përgjithshme mbi verifikimet dhe vlerësimin e kryer rreth informacionit të përcjellë nga SHISH, si dhe mbi shkresën dërguar SHISH nr. *** prot., datë 24.2.2017, për mënyrën e trajtimit dhe vlerësimin të këtij informacioni, që sipas verifikimeve të kryera ka rezultuar pa të dhëna konkrete për veprime korruptive në ngarkim të prokurorit Dritan Gina dhe çështja është arshivuar.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

112. Objekti, standardet dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit *Vetting* janë të ndryshme nga ato të hetimeve penale edhe për sa i përket komponentit të kontrollit të figurës, pasi ky proces është konceptuar si një ushtrim i jashtëzakonshëm i natyrës administrativo-disiplinore.

113. Vlerësimi i komponentit të kontrollit të figurës, sipas Kushtetutës së Shqipërisë, është nën kompetencën ekskluzive të organeve të rivlerësimit *Vetting* (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit), bazuar në raportin e përgatitur për këtë subjekt nga organet ndihmëse. Procesi i rivlerësimit *Vetting* nuk synon të konstatojë përgjegjësi penale: rezultati mund të jetë vetëm masa disiplinore, pasi ky është një proces i jashtëzakonshëm i natyrës administrativo-disiplinore, i rivlerësimit të figurës së subjektit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që nuk përjashtohet dhe nuk paragjykohet nga vendime të tjera apo me hetimet të organeve ligjzbatuese.

114. Në vijim të përfundimeve të arritura trupi gjykues çmon se konkluzionet lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting dhe konkluzionet lidhur me vlerësimin e qëndrimit të subjektit mbi procesin janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, nuk ka qene bashkepunues në kete proces si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

115. Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm arritjen e nje konkluzioni lidhur me komponentin e figures për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me te nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në rekomandimet e relatores së çështjes, pasi dëgjoi përfaqësuesin ligjor dhe subjektin në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura në vlerësimin e çështjes në tërësi, vlerësoi sjelljen e tij përgjatë procesit të rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 3 dhe 5, nenet D dhe Dh, të Aneksit të Kushtetutës, ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriteret e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 pasi nuk u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit të kryer ndaj tij, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, në datën 22.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku